



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0684

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Babita SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkolla me numër të prokurimit 632-25-1876-1-2-1, me 11.09.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Babita SH.P.K., me nr. 2025/0684, e datës 24.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkolla me numër të prokurimit 632-25-1876-1-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Komuna e Gjakovës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkolla me numër të prokurimit 632-25-1876-1-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Babita SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.03.2025 Komuna e Gjakovës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkolla me numër të prokurimit 632-25-1876-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 60,000.00 Euro.

Me 02.07.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE N.T.P., Bletaria Egzoni.

Me 07.07.2025, OEBabita SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 15.07.2025.

Me 24.07.2025, OE Babita SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0684, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Babita SH.P.K., lidhur me ankesën 0684/2025:

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për t'u siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mosrespektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht, AK pa të drejtë ka shpërblyer me kontratë OE N.T.P. Bletaria Egzoni i cili në total posedon çmimin më të lartë se tenderi jonë për 12,800.00 € përkatësisht për më shumë se 30.33%. Bazuar në nenet e cekura më lartë si dhe bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022, AK duhet të luajë rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. AK nuk e ka zbatuar fare pjesën e dytë të nenit 59.4 të LPP-së si dhe interpretimin e KRPP-së lidhur me rastet kur ofrohen pajisje më të avancuara se sa që kërkohen. Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet lehtë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 gjatë vlerësimit të tenderëve duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke mos administruar procedurën e prokurimit sipas neneve të cekura më lartë.

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave pasi ka shpërblyer me kontratë një OE i cili e ka çmimin shumë më të lartë se ne ndërsa neve na ka eliminuar nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit për t'u cilësuar si tenderues i përgjegjshëm. Mosshpërblymi me kontratë i kompanisë tonë në këtë rast përbën diskriminim të hapur ndaj nesh dhe njëkohësisht përbën shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-

së. Ky veprim përbën edhe shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së pasi që AK është duke tentuar të bëjë shfrytëzim joefikas dhe joekonomik të parasë publike. Gjithashtu kjo përbën edhe shkelje të nenit 56.3 të LPP-së sepse AK po aplikon kërkesa shtesë të cilat nuk ishin të përcaktuara fare tek FDT e dosjes së tenderit por vetëm tek lista e çmimeve. Kërkesat për ISO dhe CE certifikata kanë qenë të vendosura tek lista e çmimeve, andaj ligjërisht dhe teknikisht ato dorëzohen së bashku me artikujt gjatë liferimit. Aplikimi i kërkesave të tilla gjatë vlerësimit përpos që përbën shkelje të nenit 56.3 të LPP-së, një gjë e tillë nuk mund të funksionojë sepse CE certifikata në formën dhe vendin ku është kërkuar dorëzohet vetëm gjatë liferimit. Këto veprime të AK-së përkatësisht të Komisionit të Vlerësimit bien plotësisht ndesh me nenin 1, 6 dhe 53.6 e veçanërisht me nenin 7 të LPP-së të cilët në asnjë formë nuk ia lejojnë AK-së dhe Komisionit të Vlerësimit të ndërmarrin ndonjë veprim i cili ndikon në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë joefikase dhe joekonomike si dhe nuk ia lejojnë as që të aplikojnë kërkesa që nuk ishin tek FDT-ja, që si veprim përbën diskriminim shumë të madh ndaj nesh.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të RRPP-001/2022 pasi që nuk i ka respektuar specifikimet teknike të përcaktuara nga vet ata në listën e çmimeve. Gjatë vlerësimit nuk e ka marrë fare për bazë atë që e thotë neni 28.6 dhe 28.9 i LPP-së i cili shumë qartë e sqaron se kur specifikimet teknike janë më të larta apo avancuara dhe e plotësojnë aspektin funksional të kërkesave të AK-së, ky i fundit nuk ka të drejtë ta eliminojë nga konkurrenca OE që ka ofruar artikujt e tillë. AK tek pozicioni 1 i listës së çmimeve (Paramasa) ka kërkuar Korrëse Bari ku ndër të tjera ka vendosur si specifikim:

- Gjerësia e prerjes: 51 cm,
- Kapaciteti i koshit të grumbullimit: 55 litra,
- Motori: (3.0 kWh),
- Lartësia e prerjes: 2,5 - 7.5 cm me 7 shkallë.

Ne e kemi plotësuar këtë kriter duke ofruar pajisje më të avancuar dhe atë me këto karakteristika:

- Gjerësia e prerjes: 53 cm,
- Kapaciteti i koshit të grumbullimit: 62 litra,
- Motori: (4.5 kWh),
- Lartësia e prerjes: 2,5 - 7.5 cm me 8 shkallë.

Sipas nenit 28 dhe sipas një interpretimi të KRPP-së, kurdo që specifikimet teknike të ofruara e plotësojnë kërkesën e AK-së apo janë më të avancuara për nga funksionaliteti teknik i tyre dhe duke mos krijuar asnjë pengesë apo kosto shtesë për AK-në gjatë përdorimit, duhet të pranohen detyrimisht si kushte teknike të plotësuara. Rasti jonë është saktë sipas këtij interpretimi sepse e plotëson kushtin e kërkuar nga AK dhe ofron mundësi funksionale shumë më të avancuara duke krijuar edhe benefite të tjera në hapësirë prerëse, në volum të mbajtjes së barit të prerë, ndarje të intervalit lëvizës të lartësisë së prerjes në më shumë pjesë dhe duke ofruar fuqi më të lartë të motorit. Pra edhe pse pajisja jonë posedon 4 elemente shumë më të favorshme, ne kemi çmimin 390.00 € për copë ndërsa OE që e ka shpallur fitues e posedon çmimin 500.00 €. Kjo tregon që AK për kushte të njëjta, bile edhe më të pafavorshme siç i posedon OE i shpallur fitues, po tenton të kontrakttojë një pajisje më të shtrenjtë se pajisja jonë me paku 30% dallim. Për sa i

përket arsyetimit shtesë për eliminim të paraqitur vetëm në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk qëndron fare sepse shumë mirë e kemi cekur në katalog se gjeneratori posedon dy dalje monofazore. Fotoja është vetëm sa për ilustrim dhe në rastin konkret vlen shënimi me shkrim më shumë se sa fotoja ilustrative. Përpos kësaj AK nuk ka të drejtë që në fazën e ankimimit të shtojë arsye shtesë për eliminim sepse ne jemi privuar nga e drejta për ta kundërshtuar arsyetimin e tillë në kërkesë për rishqyrtim. Bazuar në krejt këtë, konstatojmë se AK nuk e ka respektuar si duhet nenin 28 të LPP-së, nenin 19 të RRUOPP-së por nuk ka respektuar as interpretimin e KRPP-së dhe praktikën e përditshme të OSHP-së lidhur me rastet që kur ofrohen specifikime teknike më të avancuara se sa ato që ka kërkuar AK, e të cilat ofrojnë favore për AK, nuk krijojnë asnjë pengesë funksionale dhe kanë qëndrueshmëri shumë më të lartë se sa pajisjet që AK po tenton t'i kontrakttojë, të pranohen si të rregullta. Këtë e bën edhe më të arsyeshme fakti apo favor i për AK-në që çmimi i tyre është më i ulët për më shumë se 30%. Nisur nga krejt kjo që e sqaruam dhe argumentuam më lartë, shihet se AK ka shkelur plotësisht nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të RRPP-001/2022.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur dispozitave të këtij neni. Pika 4 e këtij neni e thotë shumë qartë se: Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:

(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose

(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

E themi këtë sepse besojmë që ne si OE me çmimin shumë më të ulët në krahasim me të gjithë konkurrentët i plotësojmë edhe kërkesat e dosjes së tenderit sipas nenit 59.4 (pjesa “i” dhe “ii”) të LPP-së për t'u shpallur prapë fitues i tenderit në fjalë. E themi prapë sepse ne veç kemi qenë një herë të shpallur fitues në këtë procedurë të prokurimit. Në rastin tonë AK është dashur të aplikojë nenin 59.4 të LPP-së (pjesën “i” dhe “ii”) sepse neni 6 i LPP-së e detyron dhe i kërkon AK-së shpenzim ekonomik dhe efikas të parësë publike. Këtë e themi edhe për faktin se përpos që kemi pasur çmimin më të ulët në krahasim me OE të shpallur fitues, kemi ofruar pajisje me karakteristika teknike të plota dhe në përputhje me specifikimin teknik të AK-së ku në tre pika janë edhe më të avancuara që ofrojnë favore të lartë për AK-në. Arsyetimi i AK-së për eliminim është shumë i përgjithësuar dhe nuk ka cekur askund një arsye ekzakte se pse jemi refuzuar si të papërgjegjshëm. Kjo ligjërisht është e ndaluar, andaj mendoj se AK duhet të marrë masat korrigjuese dhe ta kthejë prapë vendimin e mëhershëm të përzgjedhjes së fituesit ku si fitues ishim vet ne.

Arsyetimi i parë – lidhur me mos plotësimin e specifikimeve teknike pa e përshkruar fare se cilat specifikime nuk janë plotësuar fillimisht konsideroj se është shkelje administrative e përpilimit të arsyetimit për refuzim e mandej fjala nuk përputhet me specifikimet teknike është e pabazuar. Me vet faktin që ne kemi ofruar karakteristika teknike më të avancuara në katër pika (nëse AK është duke aluduar në pikat e tilla), tregon se edhe pikat e tilla i kemi plotësuar. Me që AK ka

vendosur kërkesa teknike pa intervale dhe se pajisjet e tilla janë produkte të raftit, pra janë diçka që nuk kërkohet ndonjë prodhim special, devijimet minore e sidomos kur si të tilla ofrojnë favoritet për AK-në, duhet pranohen si të qëndrueshme dhe të mirëqena. Shto këtu faktin që të njëjtat posedojnë edhe çmim më të ulët që është një element qenësor i plotësimit të detyrimit të AK-së në shpenzimin e parasë publike sipas asaj që e kërkon neni 1 dhe 6 i LPP-së. Pra nisur nga kjo dhe nisur edhe nga ajo që është thënë tek Pretendimi 3 i shkeljes së nenit 28 të LPP-së, mendojmë dhe besojmë se e kemi faktuar dhe argumentuar mjaftueshëm që gjatë procedurës së vlerësimit është shkelur neni 59 i LPP-së nga ana e Komisionit të Vlerësimit përkatësisht nga vet AK-ja. Edhe fakti i shtimit të arsyetimeve kinse si mangësi në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe i palejuar të bëhet në fazën e tillë. Sqarimin se pse është i pabazuar e cekëm tek Pretendimi 3 ndërsa që është i palejuar e ka thënë shpesh edhe vet OSHP me arsyetimin se neve na është privuar e drejta që ta atakojmë si arsyetim të pabazuar për eliminim në kërkesë për rishqyrtim.

Arsyetimi i dytë – lidhur me atë që është thënë se për pozicionin 2 dhe 4 nuk i kemi dorëzuar ISO Certifikatat dhe CE certifikatat është plotësisht i pabazuar sidomos kur e marrim për bazë faktin që ISO certifikatat i kemi dorëzuar në tenderin tonë si dhe kur shohim formën e hartimit të FDT-së dhe vendin ku janë vendosur si kërkesa për plotësim. Në rastin konkret AK përpos që ka shkelur nenin 59 të LPP-së, ka shkelur edhe nenin 56.3 të LPP-së sepse po aplikon në fazën e vlerësimit kërkesa që nuk ishin të potencuara tek FDT dhe as nuk shikuar askund se si të tilla duhet të dorëzohen bashkë me ofertën. Forma e kërkesës dhe vendi ku janë vendosur këto kërkesa parimisht, praktikisht dhe ligjërisht janë dokumente që dorëzohen vetëm së bashku me artikujt gjatë liferimit. Ky aplikim i këtij arsyetimi është i pakuptimtë sidomos kur flasim për CE certifikatat të cilat nuk ka logjikë të jepen nga prodhuesit për artikuj akoma të pa furnizuar. Pra sipas asaj se si janë kërkuar, dhe me që nuk janë kërkesa të vendosura tek FDT e dosjes së tenderit, tregon qartë se si dëshmi kërkohen për dorëzim vetëm gjatë procedurës së liferimit të mallit. Pavarësisht krejt kësaj dhe pavarësisht që ISO certifikatat i kemi dorëzuar në tenderin tonë (shihi dëshmitë e bashkëngjitura ose ofertën tonë në sistemin e prokurimit elektronik), certifikata ISO dhe CE janë ngjashme dhe janë dëshmi që edhe sipas nenit 59.4 të LPP-së por edhe sipas nenit 72 të LPP-së mund dhe duhet të sqarohen nëse veç është nevojshme dhe mungojnë në ofertë. Pra fakti që AK nuk e ka marrë fare mundimin të na sqarojë edhe përkundër që dëshmitë e tilla nuk kërkohen për dorëzim në fazën e tenderimit dhe se ISO certifikatat i ka pasur në tenderin tonë, tregon për jo korrektësinë dhe mungesën e vullnetit të AK-së në shpenzim ekonomik dhe efikas të parasë publike. Ja dëshmia se ku ishin certifikatat e tilla:

Pra në rastin tonë s'kemi se si të mendojmë ndryshe përveç se është shkelur neni 1, 6, 7, 56.3 i LPP-së, është shkelur edhe neni 38 i RRPP-001/2022, neni 10.1 i UOPP-001/2023, e veçanërisht është shkelur neni 59.4 i LPP-së. Kjo mendojmë se është neglizhencë e pastër e AK-së në vlerësimin, sqarimin dhe krahasimin e tenderëve vetëm sipas kërkesave dhe praktikave të prokurimit por edhe sipas praktikave të vet AK-së që i ka aplikuar në të kaluarën, andaj konstatojmë lirisht se me këtë veprim apo mosveprim, AK ka vlerësuar në mënyrën më joligjore. Mangësitë në tenderin e OE të shpallur fitues dhe mos respektimi si dhe mos pranimi i tenderit tonë si të përgjegjshëm edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme nga dosja e tenderit dhe lista e çmimeve, e bëjnë AK-në shkelëse të plotë të nenit 1, 6, 7, 28, 56.3 dhe 72 të LPP-së, e bëjnë shkelëse të nenit 19 dhe 38 të RRPP-001/2022 si dhe e bëjnë edhe shkelëse të nenit 10.1 të UOPP-001/2023 që për pasojë rezultojnë me shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi 5. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar si duhet paragrafin 1 të këtij neni gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Arsyeja pse mendojmë

kështu është se si rezultat i mosvlerësimit si duhet sipas nenit 59.4 të LPP-së dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit, AK ka shpallur fitues një OE që posedon çmimin më të lartë se ne për 30.33% dhe që ka mangësi të të dhënave shumë të rëndësishme në tenderin e tij. Sipas kësaj me plotë përgjegjësi konstatojmë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk e ka aplikuar si duhet kriterin e vlerësimit të përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit. Ligjërisht dhe realisht në rastin konkret, fitues do duhej të shpallehim ne sepse plotësojmë paragrafin 1 të nenit 60 të LPP-së pasi që edhe jemi plotësisht të përgjegjshëm por edhe renditemi si i pari për nga çmimi me çka plotësohet në tërësi kriteri i vlerësimit: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Pretendimi 6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së, nenin 38 të RRPP-001/2022 dhe nenin 10.1 të UPP-001/2023 pasi që gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime edhe pse shihet se janë plotësuar kushtet që të kërkojë sqarime lidhur me ISO dhe CE certifikatat. ISO certifikatat veç janë dorëzuar në tender mirëpo të paktën për CE certifikatat është dashur të kërkojë sqarime. Edhe po të mungonin edhe ISO certifikatat, dihet mirë se neni 72 i LPP-së shumë qartë e thotë që: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Po ashtu e thotë edhe këtë se: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Edhe neni 38 i RRPP-001/2022 i tregon qartë AK-së se si duhet të veprohet në rast se mungon apo duket i paqartë një dokument siç është rasti i ISO (që i kemi dorëzuar) dhe CE certifikatave. Ja si e përshkruan këtë paragrafi 3, 4 dhe 5 i nenit në fjalë: Përpos kësaj edhe tabela tek neni 10.1 i UOP-001/2023 e thotë qartë që: Pra sipas krejt kësaj, del që arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë për mungesë të ISO dhe CE certifikatave është plotësisht i pabazuar, mosvlerësim real sipas gjendjes së tenderit tonë si dhe aplikim i pastër i një kërkesë që nuk do duhej aplikuar në këtë fazë. Pavarësisht kësaj, eliminimi për mungesë të certifikatave të tilla pa kërkuar fare sqarime përbën shkelje të plotë të nenit 72 të LPP-së, nenit 38 të RRPP-001/2022 dhe nenit 10.1 të UPP-001/2023.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik "BABITA" SH.P.K., me dt. 07.07.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkolla Nr. i prokurimit - 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121".

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.07.2025, pasi ka rishikuar ofertën tuaj, ka shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara. Autoriteti kontraktues ju ka eliminuar sepse ju në ofertën tuaj keni prezantuar katalogun në të cilin për pozicionin 1 keni prezantuar korrëse bari me benzinë dhe ndezje me buton, keni prezantuar motorin me 4.5 kV ndërsa është kërkuar motori me 3.0 kV. Ju gjithashtu keni prezantuar gjerësinë e kositjes me 53 cm, ndërsa është kërkuar me 51 cm. Keni prezantuar koshin e mbeturinave me 62 litra ndërsa është kërkuar me 55 litra. Në katalogun e prezantuar për pozicionin me numër rendor 5, keni prezantuar gjenerator dizel i cili

nuk është konform kërkesave të Autoritetit kontraktues, për arsye se është kërkuar që i njëjti të ketë një dalje trefazore dhe 2 dalje monofazë, kurse ju e keni prezantuar me 1 dalje trefazore dhe 1 dalje monofazë.

Ju nuk keni prezantuar ISO 9001:2015, ISO 22000:2005 dhe Certifikatën CE.

Oferta juaj nuk ka qenë konform specifikave të kërkuara nga Autoriteti kontraktues, prandaj edhe jeni eliminuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 28.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0684, ndërsa me datë 08.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0684. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEBabita SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0684, ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimet e OE Babita SH.P.K Pejë :

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara me Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejtë ka shpërblyer me kontratë OE N.T.P. Bletaria Egzoni i cili në total posedon çmimin më të lartë se tenderi jonë për 12,800.00€ përkatësisht për më shumë se 30.33%. Bazuar në nenet e cekura më lartë si dhe bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022, AK duhet të luaj rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. AK nuk e ka zbatuar fare pjesën e dytë të nenit 59.4 të LPP-së si dhe interpretimin e KRPP-së lidhur me rastet kur ofrohen pajisje më të avancuara se sa që kërkohen. Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet lehtë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 gjatë vlerësimit të tenderëve duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit

dhe duke mos administruar procedurën e prokurimit sipas neneve të cekura më lartë.

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave pasi ka shpërblyer me kontratës një OE i cili e ka çmimin shumë më të lartë se ne ndërsa neve na ka eliminuar nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit për tu cilësuar si tenderues i përgjegjshëm. Mos shpërblimi me kontratë i kompanisë tonë në këtë rast, përbën diskriminim të hapur ndaj nesh njëkohësisht përbënë shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-së. Ky veprim përbën edhe shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së pasi që AK është duke tentuar të bëj shfrytëzim jo efikas dhe jo ekonomik të parasë publike. Gjithashtu kjo përbën edhe shkelje të nenit 56.3 të LPP-së sepse AK po aplikon kërkesa shtesë të cilat nuk ishin të përcaktuara fare tek FDT e dosjes së tenderit por vetëm tek lista e çmimeve. Kërkesat për ISO dhe CE certifikata kanë qenë të vendosura tek lista e çmimeve andaj ligjërisht dhe teknikisht ato dorëzohen së bashku me artikujt gjatë liferimit. Aplikimi i kërkesave të tilla gjatë vlerësimit përpos që përbënë 5/10 shkelje të neni 56.3 të LPP-së, një gjë e tillë edhe nuk mund të funksionoj sepse CE certifikata në formën dhe vendin ku është kërkuar dorëzohet vetëm gjatë liferimit. Këto veprime të AK-së përkatësisht të Komisionit të Vlerësimit bien plotësisht ndesh me nenin 1, 6 dhe 53.6 e veçanërisht me nenin 7 të LPP-së të cilët në asnjë formë nuk ia lejojnë AK-së dhe Komisionit të Vlerësimit të ndërmarrin ndonjë veprim i cili ndikon në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë jo efikase dhe jo ekonomike si dhe nuk ia lejojnë as që të aplikojnë kërkesa që nuk ishin tek FDT-ja që si veprim përbën diskriminim shumë të madh ndaj nesh.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së dhe 19 të RRPP-001/2022 pasi që nuk i ka respektuar specifikimet teknike të përcaktuara nga vet ata në listën e çmimeve. Gjatë vlerësimit nuk e ka marrë fare për bazë atë që e thotë nenin 28.6 dhe 28.9 i LPP-së i cili shumë qartë e sqaron se kur specifikimet teknike janë më të larta apo avancuara dhe e plotësojnë aspektin funksional të kërkesave të AK-së, ky i fundit nuk ka të drejtë ta eliminoj nga konkurrenca OE që ka ofruar artikujt e tillë. AK tek pozicioni 1 i listës së çmimeve (Paramasa) ka kërkuar Korrëse Bari ku ndër të tjera ka vendosur si specifikim:

- Gjerësia e prerjes: 51 cm,
- Kapaciteti i koshit të grumbullimit: 55 litra
- Motori: (3.0 kWh).
- Lartësia e prerjes : 2,5 - 7.5 cm me 7 shkalle

Ne e kemi plotësuar këtë kriter duke ofruar pajisje më të avancuar dhe atë me këto karakteristika:

- Gjerësia e prerjes: 53 cm,
- Kapaciteti i koshit të grumbullimit: 62 litra
- Motori: (4.5 kWh).
- Lartësia e prerjes : 2,5 - 7.5 cm me 8 shkalle

Sipas nenit 28 dhe sipas një interpretimi të KRPP-së, kurdo që specifikimet teknike të ofruara e plotësojnë kërkesën e AK-së apo janë më të avancuara për nga funksionaliteti teknik i tyre dhe duke mos krijuar asnjë pengesë apo kosto shtesë për AK-në gjatë përdorimit, duhet të pranohen detyrimisht si kushte teknike të plotësuara. Rasti jonë është saktë sipas këtij interpretimi sepse e

plotëson kushtin e kërkuar nga AK dhe ofron mundësi funksionale shumë më të avancuara duke krijuar edhe benefite tjera në hapësirë prerëse, në volum të mbajtjes së barit të prerë, ndarje të intervalit lëvizës të lartësisë së prerjes në më shumë pjesë dhe duke ofruar fuqi më të lartë të motorit. Pra edhe pse pajisja jonë posedon 4 elemente shumë më të favorshme, ne kemi çmimin 390.00 për copë ndërsa OE që e ka shpallur fitues e posedon çmimin 500.00€. Kjo tregon që AK për kushte të njëjta bile edhe më të pafavorshme siç i posedon OE i shpallur fitues po tenton të kontrakttoj një pajisje më të shtrenjtë së pajisja jonë me paku 30% dallim. Për sa i përket arsytimit shtesë për eliminim të paraqitur vetëm në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk qëndron fare sepse shumë mirë e kemi cekur në katalog se gjeneratori posedon dy dalje monofazore. Fotoja është vetëm sa për ilustrim dhe në rastin konkret vlen shënimi me shkrim më shumë se sa fotoja ilustrative. Përpos kësaj AK nuk ka të drejtë që në fazën e ankimit të shtoj arsytetime shtesë për eliminim sepse ne jemi privuar nga e drejta për ta kundërshtuar arsyetimin e tillë në kërkesë për rishqyrtim Bazuar në krejt këtë, konstatojmë se AK nuk e ka respektuar si duhet nenin 28 të LPP-së, nenin 19 të RRUOPP-së por nuk ka respektuar as interpretimin e KRPP-së dhe praktikën e përditshme të OSHP-së lidhur rastet që kur ofrohen specifikime teknike më të avancuara se sa ato që ka kërkuar AK e të cilat ofrojnë favoritet për AK, nuk krijojnë asnjë pengesë funksionale dhe kanë qëndrueshmëri shumë më të lartë se sa pajisjet që AK po tenton të i kontrakttoj, të pranohen si të rregullta. Këtë e bënë edhe më të arsyeshme fakti apo favoriteti për AK-në që çmimi i tyre është më i ulët për më shumë se 30%. Nisur nga krejt kjo që e sqaruam dhe argumentuam më lartë, shihet se AK ka shkelur plotësisht nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të RRPP-001/2022

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur dispozitave të këtij neni. Pika 4 e këtij neni e thotë shumë qartë se: Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:

(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. E themi këtë sepse besojmë që ne si OE me çmimin shumë më të ulët në krahasim me të gjithë konkurrentët, i plotësojmë edhe kërkesat e dosjes së tenderit sipas nenit 59.4 (pjesa “i” dhe “ii”) të LPP-së për tu shpallur prap fitues i tenderit në fjalë. E themi prapë sepse ne veç kemi qenë një herë të shpallur fitues në këtë procedurë të prokurimit. Në rastin tonë AK është dashur të aplikoj nenin 59.4 të LPP-së (pjesën “i” dhe “ii”) sepse neni 6 i LPP-së e detyron dhe i kërkon AK-së shpenzim ekonomik dhe efikas të parasë publike. Këtë e themi edhe për faktin se përpos që kemi pasur çmimin më të ulët në krahasim me OE të shpallur fitues, kemi ofruar pajisje me karakteristika teknike të plota dhe në përputhje me specifikimin teknik të AK-së ku në tre pika janë edhe më të avancuara që ofrojnë favoritet të lartë për AK-në. Arsyetimi i AK-së për eliminim është shumë i përgjithësuar dhe nuk ka cekur askund një arsye ekzakte se pse jemi refuzuar si të papërgjegjshëm. Kjo ligjërisht është e ndaluar andaj mendoj se AK duhet të merr masat korrigjuese dhe ta kthej prapë vendimin e mëhershëm të përzgjedhjes së fituesit ku si fitues ishim vet ne

Pretendimi 5. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar si duhet paragrafin 1 të këtij nenin gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Arsyeja pse mendojmë kështu është se si rezultat i mos vlerësimit si duhet sipas nenit 59.4 të LPPsë dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit, AK ka shpallur fitues një OE që posedon çmimin më të lartë se ne për 30.33% dhe që ka mangësi të të dhënave shumë të rëndësishme në tenderin e tijë. Sipas kësaj me plotë përgjegjësi konstatojmë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk e ka aplikuar si duhet kriterin e vlerësimit të përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit. Ligjërisht dhe realisht në rastin konkret, fitues do duhej të shpallehim ne sepse plotësojmë paragrafin 1 të nenit 60 të LPP-së pasi që edhe jemi plotësisht të përgjegjshëm por edhe renditemi si i pari për nga çmimi me çka plotësohet në tërësi kriteri i vlerësimit Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Pretendimi 6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së, nenin 38 të RRPP-001/2022 dhe nenin 10.1 të UPP-001/2023 pasi që gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime edhe pse shihet se janë plotësuar kushtet që të kërkoj sqarime lidhur me ISO dhe CE certifikatat. ISO certifikatat veç janë dorëzuar në tender mirëpo të paktën për CE certifikatat është dashur të kërkoj sqarime. Edhe po të mungonin edhe ISO certifikatat, dihet mirë se nenin 72 i LPP shumë qartë e thuhet që: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Po ashtu e thotë edhe këtë se: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Edhe neni 38 i RRPP-001/2022 i tregon qartë AK se si duhet të veprohet në rast se mungon apo duket i pa qartë një dokument siç është rasti i ISO (që i kemi dorëzuar) dhe CE certifikatave.

Përgjigje e Pretendimeve e OE Babita SH.P.K Pejë :

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës Ankeses se OE Babita SH.P.K Pejë sqaron se pretendimet janë të ndërlidhura ne mes vete dhe si te tille përgjigjen e kana te njëjte Ak ne përshkrimin e çmimeve është kërkuar Korrëse Bari me benzine dhe ndezje me buton , Specifikat teknike Menyra e levizjes Vetëlevizëse Gjerësia e prerjes: 51 cm 2. Enlarese profesionale dhe pozicioni Certifikuar: CE , ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2005 4 Kazan Bojler për zierje .. Certifikuar: CE , ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2005.

Në Kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Njoftim për kontrate dhe ne Dosje të tenderit për kërkesat 9.1&9.2 e cila kërkohet: Kapaciteti teknik dhe professional Dëshmia e kërkuar dokumentare: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të cilat dëshmojnë se ka kryer furnizime të natyrës së ngjajshme për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë

Dhe se Eksperti shqyrtues thekson Hartimi i e dosjes te tenderit është kërkesës e nenit 27 te LPP dhe nenit 17 RRPP Ne përputhje me nenin 17 .12 te RRPP së 17.12 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shitesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor,

në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë

Sipas RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve paragrafi . 40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosje tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktues nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve..... dhe se 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe shqyrtimit të Njoftimit për Kontrate dhe Dosjes së Tenderit, rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka parashikuar katalog teknik dhe të Certifikuar: CE , ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2005. dhe si dokument të detyrueshëm në ndonjë nga pjesët obligative të dosjes apo në ndonjë kriter të qartë të kualifikimit ose vlerësimit. E vetmja përmendje eventuale e SPECIFIKAVE është bërë në mënyrë të përgjithshme në rubrikën përshkrim të çmimit të listës së çmimeve (Paramasa), pa e cilësuar këtë si kërkesë obligative apo kriter ndarës. Dhe duke u fokusuar në faktin se: AK nuk e ka kërkuar katalog teknik dhe të jete të Certifikuar: CE , ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2005 si dokument të domosdoshëm. OE këto dokumente i ka bashkangjitur vullnetarisht .

AK ka bërë vlerësim të papërshtatshëm duke u mbështetur në katalog (të pa kërkuar), në vend të deklaratës formale dhe përputhshmërisë me specifikimet e kërkuara në FDT ku OE ka dorëzuar edhe deklaratën e nënshkruar që pajisja i plotëson specifikat;

Pra Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit apo të Njoftimit për Kontratë nuk ka përcaktuar si kërkesë të detyrueshme dorëzimin e katalogut teknik për pajisjet dhe të jete Certifikuar: CE, ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2005. I vetmi vend ku përmendet një përshkrim i tillë është në rubrikën përshkrimi i çmimit në listën e çmimeve, por pa ndonjë formulim të qartë që ta bëjë atë dokument detyrues. Kjo qasje e paunifikuar bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, pasi Operatorët Ekonomikë nuk janë të informuar në mënyrë të barabartë e të qartë për kriteret që ndikojnë në vlerësimin e ofertës. Në rastin e lartë përmendur Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 LPP DHE UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve dhe e si përfundime Eksperti Shqyrtues Thekson se edhe sipas Dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet

kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës..

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Neni 69

Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës..... DHE UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Eksperti Shqyrtues thekson se nga shqyrtimi i plotë i dokumentacionit dhe bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit dhe Rregulloreve për Prokurim Publik, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kryer vlerësim të ofertës së Operatorit Ekonomik duke u mbështetur në dokumente (katalog teknik dhe certifikata CE/ISO) të cilat nuk ishin të kërkuara si kriter i detyrueshëm në Dosjen e Tenderit apo Njoftimin për Kontratë. Po ashtu, AK nuk ka shfrytëzuar të drejtën ligjore për të kërkuar sqarime shtesë, ndonëse ky veprim është i lejuar dhe i domosdoshëm në rastet e paqartësive. Kjo qasje bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencës dhe sigurisë juridike.

Duke përmendur këto rrethana, pretendimet e Operatorit Ekonomik OE Babita SH.P.K Pejë gjenden të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dyshemeve dhe blerja e gjeneratorëve në shkolla me numër të prokurimit 632-25-1876-1-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues ja fal besimin dhe e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin (B58) të AK-së dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin

1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Babita SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: